VENDIM
Nr. 234, datë 23.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 239, DATË 27.3.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË RE TË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr. 239, datë 27.3.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Fondet kundërparti, të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, si agjenci e pagesave, në shumën 116 350 000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limitit dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda vitit 2014".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama